



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion**

Mbledhja nr. 23/2008

Më 04. 11.2008, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-225

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani- kryetare e komisionit, Ethem Çeku, Haki Shatri, Kaqusha Jashari, Fatmir Rexhepi, Kaqusha Jashari, Sala Berisha – Shala dhe Berim Ramosaj.

Munguan: Zef Morina, Slobodan Petroviq, Safete Hadergjonaj dhe Múfera Şinik.

Të pranishëm: Ministresha e MEM-it, znj. Justina Shiroka-Pula, Avni Alidemaj, Arif Vitija, Azra Krasniqi-drejtorja e KEK-ut, Fahredin Macestena divizioni i Furnizimit-KEK-ut, Sagita Muco, Besim Zeqiri-ICO; Haredin Gërvalla Azem Rexhaj, Jbush Jonuzi përfaqësuesi i KPMM-së, Blerina Uka dhe Valon Hyseni nga NDI-a dhe Haxhi Gashi nga USAID-i

Nga Zyra Mbështetëse: Advie Morina, Besim Haliti dhe Nurie Morina;

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani-.kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 28.10.2008;
3. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës nr. 03/38 të dt. 2 tetor 2008, lidhur me fillimin e procedurave të privatizimit të distribuimit dhe furnizimit të KEK-ut.
4. Shqyrtimi i planifikimit buxhetor i KPMM-së për vitin 2009-2011.
5. Të ndryshme;

### **I. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

### **II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28. tetor 2008;**

Procesverbali i mbledhjes së datës 28 tetor 2008, u miratua pa vërejtje.

### **III. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës nr. 03/38 të dt. 2 tetor 2008, lidhur me fillimin e procedurave të privatizimit të distribuimit dhe furnizimit të KEK-ut.**

**Myzejene Selmani- kryetare e komisionit** –që në fillim shprehu pakënaqësinë ndaj mospjesëmarrjes së Ahmet Shalës, ministër të MEF-it i cili është i obliguar edhe sipas Rregullores së punës së Kuvendit. Pjesëmarrja e ministrit Shala është më se e domosdoshme për të sqaruar nismën dhe pyetjet që kanë të bëjnë me procesin e privatizimit të Kompanisë së distribuimit dhe furnizimit të KEK-ut.

**Ethem Çeku;** meqenëse ministri Shala udhëheq komitetin ndërministror për privatizim, ai do duhej që në emër të Qeverisë të marr pjesë si dhe të përcjell materialin shtesë në bazë të të cilit do mund debatohej arsyeshmeria si dhe vlerësimi i përgjithshëm për çështjen e privatizimit të sektorëve të caktuar të KEK-ut.

**Justina Shiroka-Pula,** ministresh e MEM-it, vlerësoi se pjesëmarrja e ministrit Shala dot kishte qenë e mirëseardhur për të qartësuar pyetjet konkrete për privatizim si dhe për efektet pozitive të privatizimit për të cilat çështje MEF-i është edhe kompetente kurse MEM-i është kompetente për çështjet që kanë të bëjnë vetëm me procedurat e privatizimit.

**Berim Ramosaj**-theksoi se në parim është pro privatizimit, por për rastin e KEK-ut, duhet se pari të përfundonte korporatizimi jo vetëm formal por edhe përmbajtjesor e pastaj në bazë të analizave studimore në tërësi dhe veç e veç të përfundohet se duhet dhe cilat sektorë sipas prioritetit ekonomik duhet privatizuar.

**Haki Shatri**-pajtohet me parafolësit se Qeveria duhet të bëjë transparente procesin e privatizimit pastaj “Qeveria nuk duhet ta fshehë materialin, duhet të bëjë te qartë çdo çështje dhe pyetje edhe ndaj komisionit nëse duhet të deklarohet edhe ky komision. Rekomandimi dhe vlerësimi i komisionit lidhur me këtë çështje duhet të jetë i bazuar dhe i qëndrueshëm.

**Fatmir Rexhepi**- Vendimi i Qeverisë duhet të jetë i përcjellur me material bazë në bazë të të cilit është nxjerr edhe Vendimi i privatizimit. Ai vlerësoi se duhet të jemi të përgatitur për debate lidhur me procesin e privatizimit të Kompanive publike. Ai gjithashtu propozoi që të shfrytëzohen praktikat pozitive të shteteve në rajon. Sala Berisha Shala- kishte vërejtje në mënyrën e të qasurit të anëtarëve të komisionit lidhur me çështjen e privatizimit duke vlerësuar se komisioni po luan rolin e opozitës ndaj Qeverisë.

Pas debatit të gjerë Komisioni nxori këtë :

### **Përfundim**

Komisioni në parim pajtohet me privatizimin e distribuimit për furnizim të KEK-ut por para se të miraton rekomandimi për Kuvend të Kosovës, kërkohet që Qeveria të përcjell materialin shtesë-bazë .

Në mbledhjen e radhës të shtrohet për rend dite e njëjta çështje duke i bashkangjitur materialin përkatës.

Në mbledhjen e radhës të ftohen përfaqësuesi i Qeverisë, dhe ministri i MEF-it.

### **IV. Shqyrtimi i Planifikimit buxhetor të KPMM-së për vitin 2009-2011.**

**Haki Shatri**- tha se kërkesa lidhur me Planin Buxhetor të KPMM-së, për 2009 është shqyrtuar dhe miratuar në Komisionin për Buxhet dhe i është kthyer MEF-it me rekomandim që kërkesën e KPMM ta radhisë në kornizat e Buxhetit të përgjithshëm të Kosovës për vitin 2009. bazuar në këtë informatë Komisioni miratoi këtë:

### **Përfundim**

Buxheti i KPMM-së do të shqyrtohet në kuadër të procedurës së shqyrtimit dhe miratimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009.

### **V. Të ndryshme**

**Ethem Çeku** – propozoi që të miratohet Raporti për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për akreditim pasi që ishte tërhequr nga rendi i ditës nga seanca e dt. 17.10.2008 për shkak të disa lëshimeve teknike.

**Haki Shatri**, raportues i P/ligjit për akreditim, informoi se Raporti është përmisuar dhe korrigjuar nga disa lëshime të evidentuara teknike dhe propozoi që të miratohet dhe procedohet për lexim të dytë..

Pas vlerësimit dhe vërtetimit të eliminimit të lëshimeve të evidentuara komisioni nxori këtë:

### **Përfundim**

- Miratohet Raporti për Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për Akreditim Nr. 02/L- 43.
- Autorizohet zyra mbështetëse e Komisionit për procedim të mëtejshëm të raportit.

**Ethem Çeku** - propozoi që në vazhdim të miratohet Raporti për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët nr. 2003/11.

**Kaqusha Jashari** - anëtare e grupit punues (mungonte Z. Morina, raportues) vërtetoi se raporti përmban amendamentet e miratuara në komision dhe raporti është përpunuar në frymën e kërkesave të standardizimit andaj propozoi që të miratohet raporti.

Pas diskutimit u nxor ky:

### **Përfundim**

- Miratohet raporti për P/Ligjin Nr. 02L -135, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për rrugët nr. 2003/11
- Autorizohet zyra mbështetëse e Komisionit për procedim të mëtejshëm të raportit

Në vazhdim Komisioni nxori këtë:

### **Përfundim**

- Mbledhja e radhës mbahet më 11.11. 2008 në ora 11.00 në të cilën përveç tjerash do të shqyrtohet përsëri:
- Vendimi i Qeverisë për nismën e privatizimit të Kompanisë së distribuimit dhe furnizimit me energji elektrike.
- Të ftohet përfaqësuesi i Qeverisë si dhe ministri i MEF-it.
- Të kërkohet materiali shtesë për nismën e privatizimit të Kompanisë së KEK-ut.
- Çështjet tjera për rend dite caktohen më vonë

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

Kryetare e Komisionit

Myzejene Selmani

